

VENDIM
Nr. 427, datë 10.6.2026

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR PËR NDIHMAT SHTETËRORE
TË VITIT 2025

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit vjetor për ndihmat shtetërore të vitit 2025, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

RAPORTI VJETOR
PËR NDIHMAT SHTETËRORE TË VITIT 2025

PËRMBLEDHJE

Raporti vjetor për ndihmat shtetërore është hartuar në zbatim të detyrimeve të sanksionuara në nenin 71, pika 5 të MSA-së dhe në marrëveshjen e CEFTA-s 2006, për sigurimin e transparencës ndërkombëtare. Raporti është përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Nxitjes së Biznesit, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI) mbështetur në vendimet e Komisionit të Ndhmës Shtetërore për autorizimin e ndihmës shtetërore. Në mënyrën e paraqitjes dhe analizës së të dhënave në raport është ndjekur metodologjia e Komisionit Evropian.

Të dhënat e përfshira në këtë raport janë raportuar nga zbatuesit e skemave të ndihmës shtetërore të miratuara sipas vendime të miratuara nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore, si: Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI), Ministria e Financave, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD), Bashkia e Tiranës, Bashkia Shkodër, Agjencia Startup Albania, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Raporti 2025 përfshin të dhëna për periudhën 2014–2025, duke bërë një krahasim të ndihmës shtetërore, përgjatë këtyre viteve, në nivel kombëtar, si edhe në raport me ndihmën shtetërore, të dhënë në shtetet anëtare të BE-së.

Raporti jep një përshkrim të objektivave kryesorë që janë arritur në fushën e ndihmës shtetërore në Shqipëri, si dhe të instrumentet kryesore të përdorura në periudhën 2022–2025. Shuma e ndihmave shtetërore të dhëna në Shqipëri gjatë viteve 2022–2025 është 25.551,31 milionë lekë, prej të cilave 7.756,03 milionë lekë (80.34 milionë €) që përfaqësojnë 0.29% të PBB-së janë dhënë në vitin 2025. Në totalin e ndihmës së dhënë për vitin 2025, vendin kryesor e zënë ndihma sektoriale (me 70.1%), ndërsa ndihmat horizontale përbën 29.9% të ndihmës gjithsej.

Instrumentet kryesore të ndihmës shtetërore në Shqipëri gjatë vitit 2025 janë grantet dhe përjashtimi nga taksat, rimbursimi, apo reduktimi i shkallës tatimore.

Në zbatim të nenit 32, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, raporti vjetor për ndihmat shtetërore për vitin 2025 do t’i përcillet Komisionit Evropian.

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE

I. PËRKUFIZIMI I NDIHMËS SHTETËRORE

1.2 Metodologjia për raportimin e ndihmës shtetërore

II. NDIHMA SHTETËRORE NË VITIN 2025

2.1 Vështrim mbi ndihmën shtetërore në periudhën 2022–2025

2.2 Kategoritë e ndihmës shtetërore

2.2.1 Ndihma Shtetërore Horizontale

2.2.2 Ndihma Shtetërore Sektoriale

III. INSTRUMENTET E SHPËRNDARJES SË NDIHMËS SHTETËRORE

I. PËRKUFIZIMI I NDIHMËS SHTETËRORE

- Baza ligjore

Në Shqipëri, ligji i ndihmës shtetërore përcakton rregullat e dhënies së ndihmës shtetërore duke respektuar detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim-Asociimit. Ligji i ndihmës shtetërore nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, jep përkufizimin e ndihmës shtetërore, kushtet për miratimin e ndihmës shtetërore, kompetencat e strukturave përgjegjëse, procedurën e autorizimit, monitorimin dhe kthimin e ndihmës shtetërore si edhe detyrimin për hartimin e raportit vjetor për ndihmën shtetërore.

- Përkufizimi i ndihmës shtetërore

Në bazë të nenit 4, pika 1 ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, përcaktohet, se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

Gjithashtu, neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë¹, përcakton se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”

- Përfitues i ndihmës shtetërore

Përfitues i ndihmës shtetërore është çdo ndërmarrje ose individ që, nëpërmjet akteve dhe masave të ndërmarrja nga shteti, siguron përfitime financiare. Në përcaktimin nëse një masë është ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar dhe të nenit 107 (1) të TFEU-së, strukturat e ndihmës shtetërore vlerësojnë plotësimin e kriterëve të mëposhtme:

- Masa duhet të jepet nga shteti dhe të përfshijë burimet shtetërore;

- Masa duhet të japë një avantazh ndaj ndërmarrjeve të caktuara ose sektorëve të caktuar; *si edhe*

¹ Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e ‘Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare’”.

- Masa ndikon në konkurrencë dhe mund të ndikojnë në tregtinë midis Shteteve Anëtare.

Cfarë nuk përbën ndihmë shtetërore?

a) *Ndihma për organet publike dhe njësi të vetëqeverisjes lokale dhe rajonale, të cilat kryejnë një aktivitet jo ekonomik;*

b) *Masa të përgjithshme të destinuara për të gjitha ndërmarrjet dhe të gjithë sektorët e ekonomisë në vend, të tilla si masat tatimore të përgjithshme etj.;*

c) *Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve me çmimin e tregut;*

1.2 Metodologjia për raportimin e ndihmës shtetërore

Ndihma shtetërore për industrinë dhe shërbimet përfshin kategorinë e ndihmës horizontale dhe ndihmës sektoriale.

Ndihma shtetërore horizontale përfshin:

- Ndihmën për kërkim-zhvillim dhe inovacion;
- Ndihmën për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme;
- Ndihmën për punësim;
- Ndihmën për trajnim;
- Ndihmën operacionale;
- Ndihmën për sportin;
- Ndihmën për kulturën.

Ndihma shtetërore sektoriale përfshin:

- Ndihmën për transportin publik;
- Ndihmën për shërbimin publik;
- Ndihmën për infrastrukturën *broadband*;
- Ndihmën për turizmin.

Ndihma shtetërore jepet duke përdorur disa instrumente, si:

A1 – Subvencione dhe grante;

A2 – Përrjashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulje e shkallës së tatimit ose zbritje e kontributit në sigurimet shoqërore;

A3 – Garancitë Shtetërore.

II. NDIHMA SHTETËRORE NË VITIN 2025

2.1 Vështrim mbi ndihmën shtetërore në periudhën 2022–2025

A. Ndihma shtetërore krahasuar me treguesit kryesore socioekonomike

Tabela nr. 1: Ndihma shtetërore krahasuar me disa me tregues socioekonomike 2022–2025


<i>Treguesit</i>	<i>Njësia e matjes</i>	2022	Shkalla e ndihmës 2022	2023	Shkalla e ndihmës 2023	2024	Shkalla e ndihmës 2024	2025	Shkalla e ndihmës 2025
<i>PBB</i>	<i>mln lekë</i>	2,138.3	0.29	2,311.7	0.37	2,494.2	0.31	2,642.50	0.29
<i>Të punësuar (15-64 vjec)</i>	<i>nr</i>	1,262,335	4,899	1,243,085	6,891	1,243,085	6,287	1,278,457	6,067
<i>Popullsia</i>	<i>nr</i>	2,793,592	2,214	2,761,785	3,101	2,761,785	2,830	2,363,314	3,282
<i>Ndihma shtetërore</i>	<i>mln lekë</i>	6,184.69		8,565.5		7,815.2		7,756.0	

Burimi: MF dhe MEI

Tabela nr. 1 paraqet të dhënat për ndihmën shtetërore gjithsej në Shqipëri në periudhën 2021–2025 si edhe treguesit e përqindjes së ndihmës shtetërore ndaj PBB-së; ndihmë shtetërore për person të punësuar dhe ndihma shtetërore për person të popullsisë. Ndihma shtetërore gjithsej në vitin 2025 është dhënë në vlerën totale 7.756,0 mln lekë (80.34 mln euro). Shkalla e ndihmës shtetërore ndaj PBB-së u ul nga 0.31% në 2024, në 0.29% në vitin 2025.

Grafiku nr. 1 paraqet shkallën e ndihmës shtetërore ndaj PBB-së për periudhën 2014–2025.

Grafiku nr. 1: Ecuria e ndihmës shtetërore në raport me PBB 2014–2025



Burimi: MF, INSTAT dhe MEI

B. Shkalla e ndihmës shtetërore në Shqipëri dhe shtetet e Bashkimit Evropian

Tabela nr. 2 paraqet informacion për ndihmën shtetërore në Shqipëri dhe 27 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian për periudhën 2023–2024.

Tabela nr. 2: Shkalla e Ndhmës shtetërore ndaj PBB për periudhën 2023-2024

Shtetet	Periudha	
	2023	2024
Shqipëri	0.37	0.31
Austri	0.70	0.75
Belgjikë	0.97	1.14
Bullgari	0.52	0.83
Qipro	0.46	0.56
Ceki	1.18	0.98
Gjermani	1.26	0.96
Danimarkë	1.38	1.03
Estoni	0.92	0.84
Greqi	1.25	1.17
Spanjë	1.12	0.99
Finlandë	1.11	0.85
Francë	1.35	1.17
Kroaci	1.89	1.05
Hungari	2.89	1.37
Irlandë	0.38	0.40
Itali	1.08	0.84
Lituani	1.03	0.58
Luksemburg	0.61	0.60
Letoni	0.75	0.67
Maltë	1.82	0.70
Holandë	0.56	0.50
Poloni	1.57	1.16

Portugali	0.59	0.40
Rumani	1.01	1.22
Suedi	1.07	0.80
Slloveni	1.45	0.97
Sllovaki	0.77	0.64

Burimi: Komisioni Evropian, DG Competition², MEI (%)

2.2 Kategoritë e ndihmës shtetërore

Sipas metodologjisë së Bashkimit Evropian, ndihma shtetërore ndahet në dy kategori:

- Ndhimë shtetërore horizontale; dhe
- Ndhimë shtetërore sektoriale.

Ndihma shtetërore horizontale jepet për një numër të madh përfituesish, pa dhënë preferenca për ndonjë aktivitet ekonomik, ndërmarrje ekonomike, produkt apo shërbim, duke minimizuar efektet në konkurrencë.


Ndihma shtetërore sektoriale jepet për aktivitete dhe sektorë të veçantë, duke pasur një ndikim më të madh në konkurrencën në treg.

Tabela nr. 3: Ndihma shtetërore gjithsej 2022-2025 ndarë sipas kategorive (në milionë lekë)

KATEGORIA	2022			2023			2024			2025		
	mln lekë	mln euro	në %	mln lekë	mln euro	në %	mln lekë	mln euro	në %	mln lekë	mln euro	në %
Ndihma Horizontale	1,420.29	12.36	32.57%	2,328.65	22.66	41.44%	3,198.67	32.54	40.93%	2,319.27	24.02	29.90%
Punësimi	23.01	0.20	0.5%	65.73	0.64	1.2%	49.92	0.51	0.6%	76.30	0.79	1.0%
Trajnim	21.04	0.18	0.5%	28.76	0.28	0.5%	19.74	0.20	0.3%	48.98	0.51	0.6%
Sport	587.70	5.11	13.5%	915.87	8.91	16.3%	842.55	8.57	10.8%	1,337.31	13.85	17.2%
Kultura	84.04	0.73	1.9%	156.55	1.52	2.8%	243.36	2.48	3.1%	339.87	3.52	4.4%
Ndihma operacionale	233.91	2.04	5.4%	233.15	2.27	4.1%	1,017.47	10.35	13.0%	-	0.00	0.0%
Kërkim, zhvillim dhe inovacion	161.82	1.41	3.7%	919.09	8.94	16.4%	533.29	5.43	6.8%	48.96	0.51	0.6%
SME	308.77	2.69	7.1%	9.50	0.09	0.2%	492.34	5.01	6.3%	467.84	4.85	6.0%
Ndihma Sektoriale	2,939.98	25.58	67.43%	3,291.21	32.02	58.56%	4,616.48	46.96	59.07%	5,436.76	56.32	70.10%
Transport publik (Hekurudha)	501.00	4.36	11.5%	490.00	4.77	8.7%	500.00	5.09	6.4%	500.00	5.18	6.4%
Shërbimi publik	360.00	3.13	8.3%	310.00	3.02	5.5%	350.00	3.56	4.5%	350.00	3.63	4.5%
Infrastruktura	3.16	0.03	0.1%	-	-	0.0%	-	-	-	-	0.00	0.0%
Broadband												
Turizmi	2,075.82	18.06	47.6%	2,491.21	24.24	44.3%	3,766.48	38.32	48.2%	4,586.76	47.51	59.1%
TOTALI	4,360.27	37.94	100	5,619.86	54.68	100	7,815.15	79.50	100	7,756.03	80.34	100

Burimi: MEI


Grafiku nr. 2: Ndihma shtetërore gjithsej 2022–2025



Burimi: MEI

² https://competition-policy.ec.europa.eu/state-aid/scoreboard/scoreboard-state-aid-data_en


Grafiku nr. 3: Ndhimja shtetërore horizontale/sectoriale 2022-2025



Burimi: MEI

Të dhënat në tabelën 3 dhe të paraqitura në grafikun 3 tregojnë se në vitin 2025 ndihma shtetërore horizontale zë pjesën më të vogël të ndihmës shtetërore gjithsej me 29.9%, ndërsa kategoria e ndihmave sektoriale përbën 70.1%. Në terma nominalë, shpenzimet e përgjithshme të ndihmës shtetërore në vitin 2025 u ulën me 59.13 mln lekë krahasuar me shpenzimet e vitit 2024. Në grafikun nr. 4 paraqiten të dhënat për peshën e ndihmës shtetërore për vitin 2025 për çdo kategori të ndihmës në raport me ndihmën gjithsej.

Grafiku nr. 4: Shpërndarja e kategorive të ndihmës shtetërore



Burimi: MEI

2.2.1 Ndhimja shtetërore horizontale


Në vitin 2025 ndihma shtetërore horizontale në vlerë absolute është 2.319,27 mln lekë (24.02 mln euro). Peshën kryesore për këtë kategori të ndihmës e zë ndihma për sport me 57.66, duke vijuar me ndihmën për NMVM-të (SME) me 20.17%.

Tabela nr. 4: Ndihma shtetërore horizontale 2022–2025

Ndihma Horizontale	2022		2023		2024		2025	
	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR
Punësimi	23.01	0.20	65.73	0.64	49.92	0.51	76.30	0.79
Trajnim	21.04	0.18	28.76	0.28	19.74	0.20	48.98	0.51
Sport	587.70	5.11	915.87	8.91	842.55	8.57	1,337.31	13.85
Kultura	84.04	0.73	156.55	1.52	243.36	2.48	339.87	3.52
Ndihma operationale	233.91	2.04	233.15	2.27	1,017.47	10.35	-	0.00
Kërkim, zhvillim dhe inovacion	1,985.79	17.28	3,864.73	37.60	533.39	39.33	48.96	0.51
SME	308.77	2.69	9.50	0.09	492.34	5.01	467.84	4.85
TOTALI	3,244.26	28.23	5,274.29	51.32	3,198.77	66.44	2,319.27	24.02


Burimi: MEI

Grafiku nr. 5: Ecuria e ndihmës shtetërore horizontale 2022–2025



Burimi: MEI

Grafiku nr. 6: Struktura e ndihmës shtetërore horizontale më 2025-n



Burimi: MEI

Në mënyrë më të detajuar të dhënat për ndihmën shtetërore horizontale janë si vijon:

Ndihma për punësim: Ndihma për punësim është e autorizuar me vendimin e Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 100, datë 16.10.2020, “Autorizim i ndihmës shtetërore ‘Programi i nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale’”. Në bazë të VKM-në nr. 17, datë 15.1.2020, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”, të ndryshuar, dhe VKM-në nr. 348, datë 29.4.2020, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit skema ka pasur impaktin si vijon:

- **Programi i punësimit:** Në këtë program u planifikuan 37.044.546 lekë dhe u realizuan fakt 33.359.260 lekë ose 90% e fondit të planifikuar.

Nëpërmjet këtij programi kanë përfituar gjithsej 177 subjekte, të cilat kanë punësuar 271 punëkërkues të papunë.

- **Programi i vetëpunësimit:** Në këtë program u planifikuan 43.145.445 lekë dhe u realizuan fakt 42.945.356 lekë ose 100% e fondit të planifikuar.

Numri i përfituesve (ndërmarrjeve të reja) është 224.

Ndihma për trajnim: Ndihma për trajnim është e autorizuar me vendimin e Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 100, datë 16.10.2020, “Autorizim i ndihmës shtetërore ‘Programi i nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale’”.

- **Programi i formimit nëpërmjet punës:** Për këtë program u planifikuan 22.405.318 lekë dhe u realizuan fakt 21.450.525 lekë ose 96% e fondit të planifikuar.

Nëpërmjet këtij programi kanë përfituar gjithsej 73 subjekte, të cilat kanë punësuar 156 punëkërkues të papunë.

- **Programi i praktikave profesionale:** Për këtë program u planifikuan 29.718.003 lekë dhe u realizuan fakt 27.534.087 lekë ose 93% e fondit të planifikuar.

Nëpërmjet këtij programi kanë përfituar gjithsej 41 subjekte, të cilat kanë punësuar 168 punëkërkues të papunë.

Ndihma për sportin: Ndihma për sportin është e autorizuar me vendim të Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 54, datë 26.1.2015, “Për skemën ekzistuese të mbështetjes me grante nga buxheti i shtetit në sektorin e sportit”. Për këtë skemë ndihme, objektivi kryesor i së cilës është nxitja e kulturës së sportit, edukimit të sportit dhe aktiviteteve fizike, duke rritur pjesëmarrjen e shtetasve në sport, për vitin 2025 janë dhënë 1,337.30 mln lekë.

Ndihma për nxitjen e kulturës: Ndihma për kulturën është e autorizuar me vendim të Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 56, datë 4.6.2015, “Autorizim i ndihmës shtetërore për veprimtaritë, të mirat dhe shërbimet kulturore”. Në vitin 2025, ndihma shtetërore për nxitjen e kulturës është në vlerën 339.87 mln lekë, në formën e mbështetjes me fonde publike për 29 projekte në fushën e artit dhe të kulturës dhe 281 projekteve, në kuadër të thirrjeve për projekte në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

Ndihma operacionale: Në këtë kategori përfshihen të dhëna të ndihmës shtetërore të autorizuar me vendim të Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 24, datë 2.5.2008, “Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për rimbursimin e akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuar në serrat me ngrohje për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevojat teknologjike të prodhimit”. Bazuar në ligjin nr. 114/2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar, është përcaktuar që afati i rimbursimit për lëndët djegëse të konsumuara në serrat me ngrohje, për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevoja teknologjike të prodhimit të produkteve në këta sektor, është deri më datë 31 dhjetor 2023. Për këtë arsye, nga data 1 janar 2024 është hequr rimbursimi dhe këto subjekte kanë përfituar rimbursim për aplikimet e bëra që i përkasin vitit 2023. Për rrjedhojë, kjo kategori paraqitet me vlerë zero për vitin 2025, duke shënuar mbylljen përfundimtare të kësaj mase ndihme operacionale.

Ndihma për kërkim: Ndihma shtetërore në këtë kategori reflekton efektin fiskal të përjashtimeve nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) për operacionet hidrokarbure. Kjo përfshin furnizimin e shërbimeve dhe mallrave për fazën e kërimit, të kryera nga kontraktorët ose nënkontraktorët e vërtetuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), bazuar në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar.

Për vitin raportues, efekti fiskal llogaritet si vijon:

- Referuar të dhënave të DPT: 2.02 mln lekë (llogaritur mbi shitjet e përjashtuara që në kushte normale do të tatoheshin me shkallën standarde 20%).

- Referuar të dhënave të DPD: 46.94 mln lekë (përjashtimi i TVSH-së në import për makineri dhe pajisje).

Efekti total i kësaj mase ndihme për vitin 2025 rezulton në 48.96 mln lekë.

Ndihma për SME: Në vitin 2025 janë zbatuar skemat si vijon:

1. Vendim i KNSH-së nr. 119, datë 27.6.2024, “Autorizim i ndihmës shtetërore ‘Mbështetje financiare për biznese me fokus ripërdorimin’”, të zbatuar nga Bashkia Tiranë. Skema ka si objektiv mbështetjen financiare për biznese me fokus ripërdorimin me një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse për të adresuar sfidat urgjente, që lidhen me mbrojtjen e mjedisit dhe praktikatat e konsumit të qëndrueshëm. Objektivat specifike të skemës së ndihmës janë:

- Të ofrojë mbështetje për biznese të ndryshme që kryejnë veprimtari ekonomike në territorin e administruar nga Bashkia Tiranë, si dhe të promovojë adaptimin e praktikave të ripërdorimit të produkteve;

- Të sigurojë financimin për fazat e para për sipërmarrësit dhe qëndrueshmërinë e biznesit të tyre;

Për vitin 2025 janë shpenzuar 3.45 mln lekë me 7 përfitues.

2. Vendim i KNSH-së nr. 117, datë 29.3.2024, “Autorizim i ndihmës shtetërore ‘Për fuqizimin e grave dhe nxitja e sipërmarrjes’”. Skema ka si objektiv mbështetjen e grave me një ide të qartë për aktivitetin e tyre, për fillimin ose zgjerimin e një biznesi të vogël ose shumë të vogël dhe në territorin e Bashkisë së Tiranës. Për vitin 2025 janë shpenzuar 11.96 mln lekë me 25 përfitues.

3. Vendim i KNSH-së nr. 110, datë 1.12.2022, “Autorizim i ndihmës shtetërore ‘Për ndërmarrjet sociale’”. Skema synon mbështetjen për integrimin në tregun e punës të kategorive të ndryshme të grupeve të pafavorizuara nga pikëpamja sociale dhe ekonomike përmes rregullimit të formave të mbështetjes të ndërmarrjeve sociale. Për vitin 2025 janë akorduar 13.58 mln lekë me 3 përfitues.

4. Vendim i KNSH-së nr. 123, datë 24.1.2025 “Autorizim i ndihmës shtetërore ‘Fondi për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për vitin 2025’”. Akordimi i granteve synon mbështetjen e projekteve që nxisin rritjen e konkurrueshmërisë së tyre, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve, inovacionin dhe rinovimin e teknologjisë, zhvillimin e biznesit kreativ, si dhe mbështetjen e grave sipërmarrëse, me qëllim nxitjen drejt eksportit. Për vitin 2025 janë akorduar 131.83 mln lekë dhe 85 përfitues.

5. Vendim i KNSH-së nr. 121, datë 30.7.2024, “Autorizim i ndihmës shtetërore ‘Krijimi i një skeme garancie për bizneset inovative për të rinjtë, nëpërmjet mbështetjes financiare me grante’”. Skema është konceptuar si një instrument mbështetës për të rinjtë që zotërojnë një ide biznesi inovative ose administrojnë një aktivitet ekzistues të regjistruar në territorin e Bashkisë Shkodër. Ajo synon rritjen e kapaciteteve menaxheriale, hyrjen në treg dhe konsolidimin e bizneseve në fazën fillestare. Për vitin 2025 janë akorduar 4.325 mln lekë dhe 6 përfitues.

6. Vendim i KNSH-së nr. 99, datë 16.10.2020, “Autorizim i ndihmës shtetërore ‘Mbështetje financiare (grant) për biznese të reja ‘të gjelbra’, të cilat bazohen në një model ekomiqësor, ose biznese ekzistuese, të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese ‘të gjelbra’, duke futur elemente *go-green* në to”, i ndryshuar”. Plani i ndihmës ka si objektiv mbështetjen e sipërmarrjeve të reja që aspirojnë të krijojnë biznese të gjelbra dhe ndërmarrjet ekzistuese që aplikojnë parimet e ekonomisë

së gjelbër në prodhimin produktesh dhe konsum lëndësh të para. Për vitin 2025 janë akorduar 19.5 mln lekë dhe 39 përfitues.

7. Vendim i KNSH 122, datë 27.11.2024, “Autorizim i ndihmës shtetërore ‘Grante për *startup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve për vitin 2025’”. Granti në total i miratuar në vitin 2025 ka qenë 291.514.724 lekë me një numër prej 83 fituesish, prej të cilave janë disbursuar 285.192.031 lekë me një numër prej 81 përfituesish.

2.2.2 Ndihma Shtetërore Sektoriale


Në vitin 2025 ndihma shtetërore sektoriale në vlerë absolute është 5,436.76 mln lekë (56.32 mln euro). Pesha për këtë kategori në totalin e ndihmës në vitin 2025 është 70.1%.

Tabela nr. 5: Ndihma shtetërore sektoriale 2022–2025

N d i h m a s e k t o r i a l e	2022		2023		2024		2025	
	m l n L E K	m l n E U R	m l n L E K	m l n E U R	m l n L E K	m l n E U R	m l n L E K	m l n E U R
T r a n s p o r t p u b l i k (H e k u r u d h a)	501.00	4.36	490.00	4.77	500.00	5.09	500.00	5.18
S h ë r b i m i p u b l i k	360.00	3.13	310.00	3.02	350.00	3.56	350.00	3.63
I n f r a s t r u k t u r a B r o a d b a n d	3.16	0.61	-	-	-	-	-	-
T u r i z m i	2,075.82	18.06	2,491.21	24.24	3,766.48	38.32	4,586.76	47.51
T O T A L I	2,939.98	26.16	3,291.21	32.02	4,616.48	46.96	5,436.76	56.32


Burimi: MEI

Grafiku nr. 7: Ecuria e ndihmës shtetërore sektoriale 2022–2025



Burimi: MEI

Grafiku nr. 8: Struktura e ndihmës shtetërore sektoriale 2025



Burimi: MEI

Në strukturën e ndihmës sektoriale (vertikale) për vitin 2025, peshën kryesore e zë ndihma për turizmin (47.51%).

Ndihma për transportin publik e dhënë nga buxheti i shtetit për mbështetjen e transportit hekurudhor është 500 milion lekë edhe në vitin 2025.

Ndihma për shërbimet publike: Në vitin 2025 ndihma për shërbimet publike është në formën e subvencionit nga buxheti i shtetit për 13 ndërmarrje të ujësjellës- kanalizime në shumën 350 mln lekë. Përfituesit kryesorë janë ndërmarrjet në qytetet e Durrësit, Fierit, Shkodrës dhe Elbasanit.

Ndihma për turizmin: Në bazë të vendimit të KNSH-së nr. 82, datë 17.5.2018, “Autorizim i ndihmës shtetërore ‘Për skemën e incentivave fiskale në sektorin e turizmit’”, referuar të dhënave nga DPT-ja rezulton se ndihma për sektorin e turizmit nga buxheti i shtetit për vitin 2025 është përfituar nga strukturat akomoduese nga reduktimi i TVSH-së nga 20% në 6% për vitin 2025 në shumën 4.586,76 mln lekë për 943 subjekte përfituese.

III. INSTRUMENTET E SHPËRNDARJES SË NDIHMËS SHTETËRORE

Ndihma shtetërore e dhënë nga burime shtetërore, në varësi të llojit (instrumentit) të përdorur, përbën një shpenzim real apo potencial të pasurisë publike, duke pasur një efekt në mbledhjen e të ardhurave publike. Në vitin 2024, ndihma shtetërore është dhënë kryesisht në formën e subvencioneve dhe incentivave fiskale. Referuar metodologjisë së përdorur nga BE-ja, instrumentet e ndihmës shtetërore klasifikohen, në:

A1 – Subvencione dhe grante;

A2 – Përrjashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale;

A3 – Garancia shtetërore;

B – Pjesëmarrja në kapital;

C1 – Hua të buta;

C2 – Instrumente të tjera;

D – Garancitë.


Tabela nr. 6: Ndihma Shtetërore gjithsej sipas instrumenteve

Ndihma Shtetërore	Subvencione dhe Grante (A1)	Përrjashtim nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale (A2)
Ndihma Horizontale		
Punësimi	76.30	
Trajnim	48.98	
Sport	1,337.31	
Kultura	339.87	
Ndihma operationale	-	
Kerkim, zhvillim dhe inovacion		48.96
SME	467.84	
Ndihma Sektoriale		
Transport publik (Hekurudha)	500.00	
Shërbimi publik	350.00	
Infrastruktura	-	
Broadband		
Turizmi		4586.76
TOTALI	3,120.31	4,635.72

Burimi: MEI

Instrumenti i përdorur më shumë është A2 – Përfshirja nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale (60%), A1 – Subvencione dhe Grante (40%) sikurse paraqitet në grafikun nr. 9.

Grafiku nr. 9: *Struktura e shpërndarjes të instrumenteve të ndihmës shtetërore për vitin 2025*



Burimi: MEI